



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e VII-të (shtatë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 25 janar 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10:45.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, dhe znj.Naile Ahmeti,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete, dhe Kthim-Podujevë, z.Bekim Karaxhija përfaqësues nga OSBE, dhe nga KFOR Rasztik Zita.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 09.12.2022

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 09 dhjetor 2022

2. Shqyrtimi i propozim Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e paraqiti propozim planin përkatës, ndër të tjera theksoi, kemi paraparë disa vizita si ajo e Komitetit për Komunitete që është bërë në muajin tetor të vitit 2022, të njëjtën vizitë e kemi paraparë të bëhet në tetor të vitit 2023, gjithashtu vizita që është bërë në shkollën "Ibrahim Rugova" më 22 nëntor të vitit 2022 është paraparë të bëhet më 21 nëntor 2023, ky plan do të jetë i hartuar dhe ne do t'i përmbahemi planit të punës vizitat e Komitetit për Komunitete do të jenë në rrugën "Ali Ajeti" i cili ka qenë më 10.08.2022 e që në

vitin e ardhshëm parashihet të bëhet vizita më 15.06.2023. Informimi për Komitetin ka qenë më 14.08.2022, kurse në këtë vit do të jetë më 16.08.2023, pastaj informata rreth nxënësve ka qenë më datën 05.09.2022 kurse tani në këtë vit do të jetë më 11.09.2023, çdo 6 muaj do ta bëjmë rishqyrtimin e planit që të bëjmë një përmbledhje të punës që kemi bërë si Komitet.

Për vizitat që do të bëhen jashtë Komunës së Podujevës e kemi lënë të zbrazët pasi nuk dihet se cilat vende do t'i vizitojmë dhe nga kush do të kemi ftesë për vizitë në Komuna tjera dhe për të parë nga afër punën e Komiteteve për Komunitete duke pasë parasysh fillimin e bashkëpunimit mes vete.

Njëzëri miratohet Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023, sipas propozimit përkatës të dërguar me materialin e mbledhjes.

3. Shqyrtimi i mundësive për mjete financiare për shënimin e 15 shkurtit Dita e flamurit të Ashkalive

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kam pasur një takim në Qeveri ku jam jam njoftuar se janë ndarë mjete financiare për organizmin e Ditës së Flamurit nga ana e Nivelit qendror në vlerë 10,000.00€, mjete këto të cilat do t'ju ndahen dy partive të ashalive që janë PAI-ja dhe PDAK-ja të cilat pastaj të organizojnë manifestimin qendror për çka është formuar edhe Këshilli organizativ në mënyrë që të kujdeset për organizimin e kësaj feste e cila do të mbahet në të gjitha komunat ku ka ashkali. Shuma e cekur e mjeteve buxhetore janë nga qendra rinore dhe për këtë çështje jemi takuar edhe me drejtorin e DKRS-së i cili na ka premtuar që do të ndahen mjete financiare për festën e Ditës së Flamurit të komunitetit ashkali, për shumën e mjeteve që do të ndahet nuk e dimë por natyrisht se kjo varet edhe numri i pjesëmarrësve në atë festë, prandaj në bazë të asaj që na është thënë DKRS do të mundohet të na dalë në ndihmë për organizimin e festës në fjalë dhe për çdo informatë që do të kemi nga Drejtori do të ju njoftojmë me kohë edhe juve pasi që është edhe 20 vjetori i Flamurit do të jetë festë jubilar, prandaj ju ftoj me datën 16 shkurt të merrni pjesë në manifestimin e festës së flamurit të komunitetit ashkali e cila është planifikuar të mbahet në ndonjë prej restoranteve, mirëpo nuk jemi ende të sigurt për shkak të mjeteve financiare. Së bashku me shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri e kemi bërë kërkesën në DKRS dhe tani jemi duke pritur përgjigjen/vendim sepse me 15 shkurt, festa në fjalë do të organizohet në nivel vendi.

z.Florent Hasani, theksoi, ne emër të LVV-së, e përkrahim dhe mbështetim kërkesën për mjete financiare për organizmin e Festës së Ditës së Flamurit të ashkalive, meqë është edhe një vit jubilar dhe e shohim të domosdoshme këtë mbështetje, ne do te flasim direkt edhe me drejtorin e DKRS për këtë çështje dhe do të kërkojmë nga ai që mbështetja të jetë sa më madhe.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, se edhe në vitet e kaluara por edhe në këtë vit gjithmonë ka qenë në pyetje buxheti, unë e falënderoj edhe drejtorin e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport sepse edhe ai ka qenë i angazhuar dhe me mundësit që ka edhe vitin e kaluar na ka premtuar dhe ne si ZKKK do të bisedojmë edhe me drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe me mjetet që i disponojmë do të ju përkrahim sipas mundësive që kemi mendoj që do të jetë një manifestim jubilar pasi që edhe është 20 vjetori i ditës së flamurit të ashkalive.

Më 17 shkurt është edhe dita e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe besoj se do të kemi organizim dhe manifestim edhe ne si Komunë, prandaj dhe ne si Zyrë do t'ju dalim në ndihmë me aq mundësi dhe buxhet që kemi pasi që po jetojmë edhe në kushte të vështira ekonomike por

mendoj që do ta gjejmë një zgjidhje edhe ne si Zyrë do të ju përkrahim ne organizmin e kësaj feste.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, buxheti i cili ka qenë i dedikuar për juve si ZKKK na e keni dedikuar neve me qëllim të shënimit të Ditës së Flamurit që ne të kemi mundësi ta realizojmë organizimin e këtij manifestimi pasi që ne nuk kishim mundësi ta organizonim, pra na keni dalë në ndihmë viteve të kaluara prandaj ju falënderoj shumë për kontributin e dhënë për komunitetin jo shumicë dhe për shënimin e Ditës së flamurit.

4. Të ndryshme

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, gjatë vërshimeve të fundit që ndodhën në vendin tonë e dimë që ka pasë dëme të konsiderueshme, mirëpo është diçka që nuk varet nga ne, po tek ju a keni ndonjë informatë se a ka pasur dëme nga vërshimet e fundit, ju pyes juve sepse e dimë që komunitete jo shumicë ka në qytetin e Podujevës, në fshatin Orllan etj, dhe a ka pasur dëme në këto vende pasi që vërshimet ishin të mëdha, nëse po si mundemi me ju dalë në ndihmë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne jemi interesuar se a ka pasur dëmtime në këto pjesë dhe sa jemi në dijeni komunitetet nuk ka pasur dëme, edhe pse brenga jonë më e madhe ishte për banorët e fshatit Orllan tek Liqeni pasi sasia e ujit mund të rritet atje, por për fat të mirë nuk ka pasur dëme, mandej në Lagjen “Xhafer Meta” nuk ka pasur dëme edhe pse janë afër lumit dhe shpeshherë del nga shtrati por që këtë herë ishte qetë, pastaj në Lagjen “Ali Ajeti” aty edhe ku jetoj unë nuk ka pasur ndonjë dëm sepse gjendemi në një lartësi në raport me nivelin ku mund të ketë vërshime dhe dëme, prandaj nuk jemi të dëmtuar nga reshjet e fundit që ndodhen në vendin tonë dhe njëkohësisht ndjemë keqardhje për pjesët që janë të prekura nga vërshimet.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.prot.01-060/04-0007278/23

Podujevë, 25 janar 2023

Kryesuesi i Kuvendit

Xhafer Ademi